



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 244/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rustem Thaqi kryesues, Ferki Xhaferi dhe Fejzullah Rexhepi anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e zyrtarës ligjore Edona Grajçevci, duke vendosur lidhur me ankesat e Organizatës Joqeveritare BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Kosovës të datës 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me 07.10.2019, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohen te pabazuara ankesat: Anr.244/2019, Anr.248/2019, Anr.251/2019 dhe Anr.255/2019 te gjitha te datës 05.10.2019, te paraqitura nga Organizata Joqeveritare BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të vazhdimit të sponsorimit të fushatës zgjedhore në rrjetin social “Facebook”, në ditën e heshtjes zgjedhore.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar ankesat: Anr.244/2019, Anr. 248/2019, Anr.251/2019 dhe Anr.255/2019 te gjitha të datës 05.10.2019, të paraqitura nga Organizata Joqeveritare BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA, të paraqitura kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me të cilat kanë pretenduar, se me datë 05.10.2019, gjatë ditës së heshtjes zgjedhore, kandidatët për deputet të paraqitur në ankesat e lartcekura, kanë vazhduar sponsorimin e fushatës zgjedhore në “Facebook”, edhe në ditën e heshtjes zgjedhore. Më këtë rast pretendohet se është bërë thyerje e heshtjes zgjedhore, të përcaktuar me LZP. Me propozim për PZAP-in, që ankesat të pranohen të bazuara.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të bazueshmerisë së ankesave dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, provave materiale - fotografive të bashkangjitura, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Ankesat janë të pabazuara

Paneli, paraprakisht ka vlerësuar se ankesat: Anr.244/2019, Anr. 248/2019, Anr.251/2019 dhe Anr.255/2019, te gjitha te datës 05.10.2019, janë për nga përmbajtja të njëjta, për nga natyra e shkeljes së pretenduar janë të njëjta, janë paraqitur nga e njëjta palë ankuese kundër subjektit të njëjtë politik, prandaj paneli bazuar në nenin 8 paragrafi 3 i Rregullave dhe Procedurave Nr.02/2015, të PZAP-it, në të cilën përcaktohet se: *Me qëllim të lehtësimit të*

shqyrtimit të ankesave kryesuesi i panelit vend marres mund të vendos ta bëjë bashkimin e ankesave që përmbajnë në vete çështje të ngjashme dhe se ato ankesa të trajtohen me një vendim”, andaj paneli bëri bashkimin e ankesave dhe për të njëjtat vendosi me një vendim, si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli, vlerëson se parashtruesit e ankesave në mbështetje të pretendimeve për ankesat, nuk kane ofruar dëshmi te qarta dhe bindëse edhe pse barra e te provuarit bie mbi ankuesin, në kuptim te nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, për te provuar se shkelësit e supozuar e kanë vazhduar sponsorimin e fushatës zgjedhore edhe në ditën e heshtjes zgjedhore me datë 05.10.2019.

Nga provat e ofruara nga ankuesi, nuk mund të vërtetohet në mënyrë bindëse dhe të qartë se reklamat e shkelësve të supozuar janë publikuar apo kanë vazhduar sponsorimet e fushatës zgjedhore edhe në ditën e heshtjes zgjedhore, sepse me asnjë provë shkresore nuk është argumentuar data dhe ora e reklamave te shkelësve të supozuar që pretendohet, se janë publikuar apo kanë vazhduar sponsorimet e fushatës zgjedhore edhe në ditën e heshtjes zgjedhore.

Ditën e shqyrtimit te këtyre ankesave, paneli ka hetuar nëse sponsorizimet e supozuara janë aktive por qe nuk ka qenë e mundur te vërtetohet në rrugë elektronike nëse te njëjtat një ditë me parë kanë qenë aktive dhe në kohën e testimit te njëjtat kane qene jo aktive.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr.244/2019 më datën 07.10.2019

Kryesuesi i Panelit
Rustem Thaçi



Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, në kuptim të nenit 118 paragrafi 4 i LZP-së.*